



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-8743/20 datë: 05.06.2020



Npi – 01/120 datë: 09.06.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 09.06.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 09.06.2020 (e martë) në ora 10.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët, z.Hamëz Tërshani; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2020.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, e njoftoi Komitetin për Politikë dhe Financa se për shkak të zhvillimeve të shpejta nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila dje ka dërguar propozimin për Rishikim të Buxhetit për vitin 2020, me procedure të shpejtë, jemi obliguar që ta thërrasim këtë mbledhje me një pikë të vetme të rendit të ditës, Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2020. Hapi diskutimin formalisht për rendin e ditës.

Në vazhdim Kryesuesja konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e prezantoi këtë pikë duke lexuar materialin në pikat kryesore. Ajo tha se dokumentin tani më e keni marrë dhe e keni lexuar, nëse ka ndonjë pyetje unë jam gati tu përgjigjem, (shih dokumentin). Arsyeja e ngutjes për shqyrtimin e Rishikimit të Buxhetit për këtë mbledhje është se Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar që ta aprovojme sa më shpejt Rishikimin e Buxhetit Komunal për vitin 2020.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, fillimisht i urojmë Hamzës postin e drejtorit. Në fakt unë në këtë Rishikim nuk kam ndonjë vërejtje, mirëpo po shikoj se ku me i marrë nja 30.000€ për rregullimin e varrezave në Shitë, sepse Imami i Xhamisë ka thënë se tani më janë shumë ngushtë. Propozoj që

30.000€ të merren nga projektet kapitale te numri 27 “Ndërtimi i shkallëve te Shtëpia e Kulturës, deri te Qendra Rinore”.

z.Ruzhdi Jashari; Përsëritet, këtë mbledhje e keni shpejtuar për shkak të nivelit qendror. Mendoj se në Kuvend nesër mundet me pas lëvizje të pozicioneve. Sa i përket akomodimit të kërkesave mendoj se nuk është adekuate me i marrë mjetet nga projektet kapitale e të qohen te kategoria shërbime dhe mallra, nuk është ky një standard por sidoqoftë ju e keni propozuar kështu. Ne si Vetëvendosje nuk kemi ndonjë qëndrim direkt për këtë.

znj.Arbresha Sylja; Përsëritet, siç e dini këtë mbledhje e ka ndikuar Pandemia KOVID19, kështu që mjetet janë marrë aty ku ka pas mundësi. Unë jam që ta aprovojme. Sa i përket propozimit të kolegut nga LDK-ja për varrezat, mendoj se është mirë që të diskutohet në Kuvend.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Sqaroi se nuk kemi pas një vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës se ku duhet të merren mjetet, nga cila kategori, për rastin e Pandemisë, por jo edhe për qëllime të tjera. Mjetet i kemi marrë te ato projekte ku kemi pas mundësi, e që realisht ato projekte nuk mundën me u realizuar. Asnjë shumë nuk është marrë deri tani nga Qeveria për sa i përket Pandemisë KOVID19.

znj.Zarife Rexhaj; Përsëritet, unë kam një pyetje për ZKF-në, se kur mundën me u kthyer mjetet financiare që janë marrë nga projektet kapitale, që mundësia e realizimit të tyre ka qenë më e vogël, ashtu siq po thoni ju?

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Sqaroi se, shuma e këtyre katër projekteve nuk kthehet.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi që ti rekomandoj Kuvendit aprovimin e Vendimit për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2020.**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 10.26h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj